



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, datë 15.04.2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Besim Sula, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Sulova”, në: *“Njësitë Administrative Tregan dhe Shirgjan (të Bashkisë Elbasan)”*. (Vendim nr. 33, datë 15.04.2024).
2. Rinovimin e autorizimit dhe zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Libcom” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Libcom”, duke hequr nga zona e ofrimit shërbimit: *“Njësitë Administrative Shirgjan dhe Tregan (të Bashkisë Elbasan)”*. (Vendim nr. 34, datë 15.04.2024).
3. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Media Kontakt” sh.p.k., licencuar për subjektin audio analoge privat rajonale “Radio Kontakt”. (Vendim nr. 35, datë 15.04.2024).
4. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “NetworkAlbania” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Network Albania”. (Vendim nr. 36, datë 15.04.2024).
5. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “NetworkAlbania” sh.p.k., autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Netalb”. (Vendim nr. 37, datë 15.04.2024).
6. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të autorizimit të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të

tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Vodafone TV”, në: *“Njësitë Administrative Sarandë, Ksamil, Lezhë, Shëngjin, Rrethinat, Bucimas, Velabisht dhe Sukth”*. (Vendim nr. 38, datë 15.04.2024).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 15 prill 2024